

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Përplasje në horizont? Izraeli kërkon “kompensim” nga SHBA-të
ADRESA	https://www.gazetatema.net/bota/perplasje-ne-horizont-izraeli-kerkon-kompensim-nga-shba-te-i587045
BURIMI	gazetatema.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	19 shtator 2026, 10:23:11 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	19 shtator 2026, 10:55:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	3f662a92bfb4d040aadaad30ee67855ea42bc73841c7dfd2b9a2acf5188bb1b9
TEKSTI	9c44447a0470190415dcd24ccf2fbd0f512615ae21c57302896f8596bebb8ba5
PAMJA	2a5abf7bd49284239c4b9db2b388c22c3bc3f98057d7cff69ff124271d2b6f7a

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	713022038f67590bc61c0ddd147c9f11baf765ff6224968edb6223f3fb71562d
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërin nga tri gjendjet — **nuk u gjet, në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/713022038f67590bc61c0ddd147c9f11baf765ff6224968edb6223f3fb71562d>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)

English

Built and Monetized by

[Kontakt](#)



English



1 e [Krim i rende ne Tirane! Burri vret me thike bashkeshorten Policia e Tiranes jep detaje nga plagosja: U qellua ajer pas nje konflikti çasti, autori ne Kerkim Shteti qe meson f](#)
fundit

Përplasje në horizont? Izraeli kërkon “kompensim” nga SHBA-të



19 Shtator 2026, 12:55 Bota TEMA



Izraeli pritet t'i kërkojë Shteteve të Bashkuara pajisje dhe kapacitete shtesë ushtarake, në kuadër të një “kompensimi” pas miratimit nga Washingtoni të shitjes së avionëve luftarakë F-35 për Arabinë Saudite.

Sipas medias izraelite Walla, Tel Avivi synon të kërkojë sisteme armësh që administrata e presidentit amerikan Donald Trump kishte refuzuar më herët t'i miratonte.

Kërkesat e Izraelit pritet të shkojnë përtej avionëve të avancuar luftarakë dhe teknologjisë stealth. Sipas raportit, në fokus janë edhe armët me bazë në hapësirë, si dhe zhvillimi dhe prodhimi i sistemeve të reja për interceptimin e kërcënimeve.

Në listën e pajisjeve që mund të kërkohen përfshihen edhe municione për depërtimin e bunkerëve dhe sisteme nëntokësore të afta të operojnë në thellësi të mëdha nën formacione shkëmbore.

Kjo kërkesë lidhet me shqetësimet e Izraelit pas vendimit amerikan për shitjen e avionëve F-35 Arabisë Saudite. Të enjten, Departamenti amerikan i Shtetit miratoi një shitje të mundshme në vlerën 24.3 miliardë dollarë, që përfshin 48 avionë F-35. Marrëveshja duhet ende të kalojë procesin e shqyrtimit në Kongresin amerikan.

Paketa e propozuar përfshin gjithashtu 49 motorë Pratt & Whitney F135-PW-100, pajisje për komunikime të sigurta, sisteme për luftën elektronike, trajnime dhe mbështetje logjistike.

Nëse marrëveshja finalizohet, Arabia Saudite do të bëhej vendi i parë arab që operon avionë F-35, ndërsa Izraeli është aktualisht i vetmi shtet në Lindjen e Mesme që i përdor këto avionë.

Çështja vjen në një moment kur marrëdhëniet mes Izraelit dhe Arabisë Saudite mbeten të lidhura me çështjen palestineze. Riadi ka deklaruar se normalizimi i marrëdhënieve me Izraelin lidhet me krijimin e një shteti palestinez përgjatë kufijve të vitit 1967, një qëndrim që Izraeli e kundërshton.

 Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

[Vrasje brutale në Kolumbi! Autorja i zuri pritë para biznesit, biznesmeni 61-vjeçar vritet me 11 plumba](#)

10:05 Bota / 6 komente

JPMorgan: Nuk kemi më një skenar bazë për naftën, lufta me Iranin ka kaluar çdo parashikim

09:55 Bota / 1 koment

Akuzohet se gënjeu FBI-në përpara se të qëllonte një venezuelian në Minneapolis, agjenti i ICE-së deklarohet i pafajshëm

09:45 Bota

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.